ADEM ZAPLLUZHA

NJË SHI PREJ BRYME

Poezi

Redaktor:
Dilaver Goxhaj

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

NJË SHI PREJ BRYME

Poezi

“TREND”
2015

DY FJALË PËR LIBRIN ME POEZI **"NJË SHI PREJ BRYME"**

Libri i 117-të i poetit Kosovar Adem Zaplluzha, **"Një shi prej bryme",** ndryshe nga botimet e mëhershme, paraqet një cikël jo të pakët poezish, vëllim që dallohet nga poezitë e tij të mëparshme, për faktin se janë poezi jo me varg të rimuar. Si i tillë, ky botim i tij i radhës ngjan më së shumti me një prozë poetike pasi, po ta vëresh me vëmendje, të gjitha poezitë e këtij vëllimi duket sikur janë vijim i njëra-tjetrës, si një histori e tërë e vuajtjeve të autorit por që personifikon gjithë popullin shqiptar në Kosovë, duke ecur përmes "një ure të ngushtë e të gjatë", sikundër thuhet në njërën prej këtyre poezive. Si i tillë, ky vëllim ngjan si një poemë liriko-epike tregimtare, si një tregim në vargje. Heroi i këtij tregimi në vargje është vetë autori, i cili tregon në mënyrën më lakonike që mund të bëhet, (ka shumë raste që i tregon ato edhe me një e dy vargje), ndjenjat e veta të shkaktuara nga ngjarjet jetësore të tij, të fisit të tij dhe të fshatit e qytetit ku ai ka jetuar e punuar, jetë, e cila është tipike për gjithë popullin e vendit të tij, Kosovës. Këto ndjenja

Adem Zaplluzha i shpreh në digresione lirike e me një kolorit emocional.
Nisur nga veçoria e këtij vëllimi, pa frikë mund ta krahasojmë me tregimet poetike si “Demoni” i Lermontovit, “Gjermania, përrallë dimri” e Hajnes apo edhe me “Gjauri-n” e Pushkinit, me të vetmin ndryshim se Ademi u ka vënë titull çdo pjesëze, pasi nuk ka pas qëllim që ta trajtonte si poemë tregimtare, kjo i ka dale rastësisht e tillë, ngaqë nuk gjendet në të një subjekt i mirëfilltë, në kuptimin e vërtetë të fjalës; gjejmë më tepër një paraqitje lirike të ndjenjave për copëza të caktuara të jetës së tij, se sa një tregim të vërtetë e të gjatë.

Themi se është në tërësi një tregim lirikë, pasi e pasqyron jetën duke treguar ndjenja të ndryshme të tij si dhe mendimet dhe emocionet e tij, të shkaktuara nga vuajtjet e

gjithë popullit të tij. Kushdo që e lexon qoftë edhe disa nga poezi të shkëputura të këtij vëllimi, përfytyron si vuajtjet e Ademit ashtu edhe ambientin shoqëror të Kosovës të atëhershëm e të tashëm, ambient, i cili i ka shkaktuar këto emocione. Themi se është një tregim lirik në vargje pasi në të ekzistojnë të gjitha tiparet e pasqyrimit artistik të figurshëm të jetës që ka lirika:

përgjithësimi, individualizmi, elementi i trillimit, si dhe rëndësia edukative. Të gjitha këto tipare bëjnë që Ademi të na e japi sa më mirë vrullin e ndjenjës dhe të folurit e emocionuar.

Si i tillë, ky vëllim më së shumti është një lirikë politiko-filozofike dhe peizazhi, pa harruar të themi se metafora është tipikja më dalluese e autorit edhe në këtë vëllim.

Dilaver Goxhaj
Tiranë, 15 Gusht 2014

Ulërinë gjethet e çmendura
Cikli i parë

PO ECIN EDHE RRUGËT

Përtej ëndrrave tona
Pasqyra e ngrirë
Një kalorës nate
Trokon nëpër errësirë
Trokon duke i shaluar lisat

Po ecin edhe rrugët
Ushtarët e vetmuar nuk e kuptojnë
As vetveten
Nuk dinë më
A thua vallë janë ushtarë të vjetër
Ose dezertorë të rinj

NË HESHTJE MORTORE

Kanë ikur zogjtë
Si copa eshtrash janë fshehur
Në thellësinë e baladave të mykura
Dhe pa dashje
Fundosën deri në fyt
Nëpër mëkatet e pëshpëritjeve

Në shpirtin e grisur të natës
Fle një zog i shurdhër
I cili nuk kupton
A është natë
Ose një kohë e egër
Mes disa kohërave asnjanëse

Diku një fyell i trishtuar
I ndërronte perdet e kohës
Rrugëve të shkelura nga dhembjet
E padurueshme kukasnin qyqet

Të heshtur kapërcejnë priftërinjtë
Kapërcejnë të trishtuar
Nëpër një golgotë dhembjesh
Në heshtje mortore
Dënesin kryqet e verdha

ULËRIN GJETHET E ÇMENDURA

Nëpër shëtitoret e qytetit
Copëra mermerësh
Kanë dalë evgjitët rrugëve
Dhe me lotët e gjelbër të hënës
Qepin astarin e shqyer të mjegullave

Me një tegel mbarë
E një tjetër për së mbrapshti
I arnojnë dhëmballët e shqyera të shiut
Ulërin gjethet e çmendura
S'ndalen as të lehurat e gjelbërimit

Një oxhak i vjetër gjysmë i rrënuar
Rri varur në një degë pjeshke
Kajsishtat e lagjes prehen
Nën gjethet e fishkura të stinës
Fëmijët bonjak shikojnë me lakmi
Ardhjen e të reshurave të vjeshtës

Portat e mbyllura fshihen pas drynave
Një duhmë e rëndë si avulli i nxehtë
Çohet nga oborret brenda mureve
Qyteti i ngufatur nga shirat e turbullta
Vuan nga një kokë dhembje
E panjohur deri më sot

FLENË MENDJET E SHTHURURA

Çdo mëngjes pa hipur këndesi në tra
Këndej kalërojnë kuajt e rrufeve
Më mëgojëza të arta
Hingëllojnë shirat e portokalltë

Ky qiell i vrarë i atdheut tim
Herë duket i verbër
E herë galopon pa syze
Nëpër syprinën e lumit të ngufatur

Kur lodhet
Ulet buzë brigjeve shterpe
Dhe i kashais kuajt e egër të erës
I kashais derisa e zë gjumi sterrën

Nga gishtat e qytetit
Si nga kryqi i golgotës
Çurgon një lloj gjaku i tejdukshëm
Çurgon dhembja e shpirtrave

Nën pemët e ngarkuara me mëkate
Flenë mendjet e shthurura
Një erë e tërbuar frynë dunave
Grykës së maleve ringjallet Kanuni

DO KTHEHEM TE TI NJË DITË

E lashë pas shpine atdheun
Dhe si i çmendur e mora dynjanë
Një lot i zi
Pikoi nga sytë e tu moj nënë

Ky mall që s'po më lë rehat
Në çdo hap frymën ma zë
Edhe ditët më bëhen natë
As frymëmarrja nuk më dëgjon më

Do kthehem te ti një ditë
Sërish te ai loti i zi
Ti atdhe beso dhe më pritë
Askund nuk ekziston si nëna Shqipëri

Prishtinë, 4 korrik 2014

NUK PUSHOJNË AS ETHET E VERËS

Si nëpër disa përralla të lashta
Zgjohen zërat në mua
Shiu i shurdhët i pranverës
Troket
Pandërprerë trokasin hijet
Nëpër muret e sëmura të kujtesës

Nuk pushojnë as ethet e verës
Gjelbërimi i zverdhur
Kafshon drurin mu në lulëzim
Një zi baritoni dëgjohet
Si zëri i lashtësisë
Hukat mbi gurtë e murrmë të atdheut

Nëpër fusha s'pushojnë
Krakëllimat e korbave
Një hije e zezë sterrë
Ra mbi çatitë e djegura
Flaka e verdhë
Çmendurisht lëpin ajrin e shkrumbuar
Të frymëmarrjes

ME UJIN E SHENJTË TË DARDANISË

Pikë uji s’paska mbetur këtu
Për mëllenjat e bardha
Po digjen fushat
Nga zëri i trishtuar i tokës
Oshtinë malet

Si zana e malit
Një vashë e bukur prej mëllenje
Me një shtambë deltine
Shuan etjen e përflakur të atdheut
Nën hijet e rrapeve
Digjen edhe gurtë e stralltë

Dielli i çmendur
Si një saç i zjarrtë
Rri mbi kokat e ushtarëve
Po kallen kallamishtet
Një zjarr i lig e ka marrë dheun
Si breshkat po piqen gurtë e plagosur

Vetëm një vashë sykaltër
Ajo e fushës së mëllenjave
Me ujin e shenjtë të Dardanisë
Shuan etjen
E plagëve që kullojnë trishtim

DËNESIN KUAJT E PLAGOSUR

Mbi flokët e shprishura të plagëve
Po bien shirat e një pranvere
Hingëllojnë edhe kuajt e sëmurë
Çadrat e bardha
Mbuluar e kanë fushën

Diku nga veriu
Depërton një duhmë e djegur
Piqet druri në rrënjë
Në Fushën e Mëllenjave
Dënesin kuajt e plagosur

Beteja e gjunjëzuar
Ngriti sytë kah qielli
Shikoi saçin e përskuqur mbi kokë
Përreth shelgjishteve
Po del flaka nga majat e plepave

Një zjarr i çmendur me qindra vjet
Kullon nga plagët e fushës së mëllenjave
Kullojnë edhe ëndrrat e trishtë
Të një populli që s'u ngop
Nga një uri e pangopshme njerëzore

SIVJET PO FRYN NJË FLLAD I RI

Brenda meje
Një fushë e errët
Si qukapikët mëllenjat e bardha trokasin
Në portat e mbyllura të ashtit

Rrufetë si kamxhikët e perëndive
Shkrepin xixa qiellit të vrarë
Nëpër foletë e braktisura
Disa zogj çelin vezë të ngjyrosura

Qyteti i lënë në harresë
I ushqen mëllenjat e fundit
Një shi i rreptë
Si gjarpri i zi lëshohet ullukëve

Nga malet e mira
Sivjet po fryn një fllad i ri
Nuk pushojnë as fluturimet e zogjve
Dielli sërish pas dymijë vjetëve
Po lind në një formë krejtësisht tjetër

ASNJË ZË NJERIU NUK DËGJOHEJ

Më kujtohet
Ishte një dimër i acartë
Stuhia i shkundte gjethet e ngrira
Nga shpirti i tërbuar i mjegullave

Në stele
Dëgjohej një kuisje e padëgjuar
Kuiste edhe fërfëlliza

Ne kishim dalë nga lëkura e erës
Dhe prisnim
Që ky dimër të shkundej
Dhe t'i shkundte ethet e zeza

Asnjë zë njeriu nuk dëgjohej
Vetëm hapat dhe rrapëllimat e dyerve
Tregonin se diçka po ngjan në qytet

Ne ishim në pamundësi
Të bëjmë diçka më shumë
Na kishte hyrë frika në shpirt

Me habi i shikonim
Me zogjtë e trembur
Vetëm ikjen e kishim parasysh
Dhe me shekuj nuk u ndalëm

DËGJOHESHIN EDHE ULËRIMAT

Ishte një natë e errët
Një kalë i zi
Pa kalorës
Hingëllonte fushave të gjëra
Nga një diell i përskuqur
Binin gjethet e para të një dimri

Mesdita as me diell
E as e errët
Një kohë e dyshimtë
Mes sterrës dhe dritës së padukshme
Tundej si vdekja
Mes çadrave të lidhura me pashnik

Pallje devesh dhe hingëllima kuajsh
Dëgjoheshin edhe ulërimat
E bishave

Si lisat e prerë binin flamujt
Binin koka njerëzish
Mes një fushe mëllenjash të përgjakur
Binin hijet e ngrira dhe kryqet
Në honin e pafund të frikës

Një kacafytje e paparë
Nga ndryshku i shpatave
Dëgjohen gjëmat
E pandërprera

Dita tërë ankth shikonte diellin
Në maja shtizash
Fundoseshin kryqet e thyera
Dhe flamujt e të gjitha reparteve
Notonin në gjak njeriu

NJË RE E ZEZË SI NATA

Sonte qenkan çmendur perëndit
I thyen lugët
Në një fushë të pafund
Nuk fluturojnë më zogjtë e imtë
Vetëm krakëllimat e korbave
Dëgjohen si simfonitë
E netëve të gjata e të trishtuara

Një zë i rebeluar si nga varri
Del në shesh
Jehon gjëma e kambanës së sëmurë
Lejlekët nuk kanë më se ku të ndalen
Asnjë oxhak çatie
Nuk lëshon tym në shpirtin e fushës
Mëllenjat e kuqe
Ikën tej bjeshkëve të Nemuna

Një Zot e di
Se çfarë ngjau me devetë
Që notonin mbi gjak njeriu
Engjëjt e tmerruar
I fshehën në kujtesën e një dite
Ikonat e përdhosura nga gjysmëhëna
Një re e zezë si nata
Mbuloi trishtimin e një fushe

KËTU EDHE NETËT DËNESIN

Sa e sa herë ka ngjarë
Që në këtë fushë të shoh
Ose të dëgjoj
Disa zëra të lashtë
Dy kuaj binjak me shekuj
Nuk i ndalin hingëllimat e një trishtimi

Këtu edhe netët dënesin
Një këngë mallkimi
Asnjëherë nuk e mësoi
Gjuhën e heshtjes
Ajo përherë dëgjohet
Dhe mbanë peng në shpirtin e saj
Amanetin e pashkruar të një luftëtari

Disa gur mermeri të kuq
Skuqur nga gjaku i njerëzve
Dhe kuajve të plagosur
Mëngjeseve herët i imitojnë zërat
E mburojave
Që nuk ditën të mbrohen askurrë
Dhe ta mbrojnë atdheun

DERDHUR NGA SQEPI I NJË MËLLENJE

Ende shoh në muzeun e qytetit
Se si një zog i verbër fluturon
Bredh nëpër raftet e librave të vjetër
Prej një kohe në tjetrën
Kur ndalet nëpër skutat e pluhurosura
I shkund flatrat dhe sqepin

Herë pushon
Në maje të një shpate të thyer
E herë mbi disa shkrime të vjetra
Mbase po hulumton
Diçka të fshehur nga koha
Ose historia lavire e kohës

Kjo prostitute e papërmirësueshme
Akoma nën brekët e saja i fsheh
Lumenjtë e gjakut
Derdhur nga sqepi i një mëllenje

Një hënë e shëmtuar
Nuk e ndalë galopin asnjëherë
Nëpër trupin e vrarë
Dhe të plagosur të atdheut tim jetim
Vrapojnë hienat e zeza

KY TESTAMENT I GURTË

Në një fushë të vogël
Mbuluar me mjegull prej gjaku
Po ia lë peng kohës
Këtë testament të gurtë

Një zog prej argjile
Dhe një korb i verbër si nata
Në një qivur të shimshirit
I kërkojnë galopet e kalorësve Dardan

Nën një hënë që shndrin
E nuk është në gjendje ta ngrohë
As ashtin e vet të thyer
Çfarë mund të pret një poet si unë

Ky testament i gurtë
Nga mermerët e kuq të Kosovës
Paska mbetur peng i shekujve
Dhe sot po qan me ngashërim si një kalama

ERDHËN EDHE SHIRAT E BRYMTA

Në këtë fushë të gjorë
Nuk paska mbetur asnjë mëllenjë
Kush i vrau fluturat e verdha
Kur deshën atë ditë qershori
Të identifikohen me flakën e zjarrit të verdhë

Një gjëmë e nëndheshme
Për herë të parë i zgjoi
Kalorësit e gurtë të baladave
Erdhën edhe shirat e brymta
Nga ajo tjetër pjesë e botës

I tërë Adi i shkuli flokët e erës
Një botë e huaj qante me hidhërim
Në sqepat e mëllenjave
Dielli për herë të fundit lindi
Pas atyre maleve që u konvertuan në djaj

Eolin e çmendur gjatë tërë shekujve
Nuk e zuri gjumi
S'fjetën as lisat e shkulur
Fluturimet e mëllenjave ëndërrojnë
Tokën e premtuar prej Hyjit

KALI IM I BARDHË

Vetëm ti kali im i verbër
Nuk je duke shkelur në këtë fushë
Mbi kufoma njerëzish
Sa i bukur je kur galopon
Nëpër mjegullat e kohës
E cila i vrau gjyshërit e mi

Kali im i bardhë
Shpirti im i verbër prej kristali
Asnjëherë nuk deshe
Ta ndalësh vrapin
Por në secilin varr të bardhë
Mbolle nga një lule prej dhembjeje

Kali im i bardhë
Kali im i zi
Akoma vrapon si era
Nëpër sqepin e plagosur
Të mëllenjës nënë

kali im i bardhë
Kali im i zi dhe i verbër
Vrapo e mos u ndalë askurrë
Nëpër Dardani
Kali im i bardhë kali im i zi

NUK NGJAJNË ME ASNJË STACION

Rrugët dhe trotuaret
Gjarpërojnë deri në pafundësi
Nuk ngjajnë me asnjë stacion
Të autobusëve të qytetit tim
Paskan emra qesharak
Si të klounëve

Ndonjëherë
Më duken të zbrazëta
Si kungujt e papjekur
Vitrinat zbukurohen me kukulla të gjalla
Që mbajnë dhëmbë artificial prej fildishi

Djemtë nuk duken si në qytetin tim
Pak janë të zbehtë
Ngjajnë kukullave prej dylli
Dhe mbajnë syze
Me dioptri të madhe dhe të pabesueshme

Edhe fushat në këtë vend
Dallojnë shumë
Nuk kanë kurrfarë ngjashmërie
Me ato të atdheut tim
Ku mbinë fasulja
Edhe nëpër shpirtrat e manaferrave

Vetëm diçka dallon në këtë fushë
Gjërat më duken tepër qesharake
Dhe njëkohësisht bonjake
Sepse këto fusha të braktisura
Nuk përkundin asnjëherë varre

KËSHTU PËRSËRITET HISTORIA

Sërish dramat nuk përfundojnë
Nën rrënjët e akacieve
Për çdo pesë dekada zgjohet
Një këndes i çmendur
Çmendurisht këndon
Mbi trarët e djegura të mendjes

Po ato erëra frynë
E s'ndalen nga të katër anët e dheut
Sërish shiu i zi troket
Nëpër degët e thyera të plepave
Dëgjohen krakëllimat e betejave

Një ushtri e degjeneruar
E thyen qafën
Tjetra veç këndon
Himnin e saj të trishtuar
Dhe të nesërmen
Kthehet mbi llafet të shfryer

Kështu përsëritet historia
Një palë njerëzish largohen
Të trishtuar si nata
Kurse pala tjetër i harron këpucët
Te varret
Dhe ikën zbathur nëpër lëndinën e vdekjes

ASNJËHERË NUK TA PAMË FYTYRËN

Edhe me varre
Je e bukur si zanat e maleve
Fusha ime e mëllenjave
Ngjan me nuset e legjendave
Që lindin vdesin
Dhe jetojnë me hirin

Një ditë je e mbushur me gëzime
Kurse ditën tjetër
Mbi supet e tua
I ngarkon të gjitha hallet
E një populli të përvuajtur

Asnjëherë nuk ta pamë fytyrën
E mrrolur
Përherë qeshe
Dhe nga vdekjet e panumërta
Ngrite përmendore të mermerta
Atyre që u shndërruan në pavdekësi

Prishtinë, 5 korrik 2014

FUSHA E MËLLENJAVE

Nëpër këto fusha të paanë
Mbinë dhe rriten lule bozhuret
Sa të bukura
Po aq edhe madhështore
Duken në gjoksin e vrarë
Dhe të çarë të Fushës së Mëllenjave

Mëngjeseve herët
Ngjajnë me flamujt miniaturale
Secila rrënjë që mbinë këtu
Rritet duke i stolisur fushat
Me një histori të trishtë prej gjaku

Valëviten lulëkuqet si kujtimet e hidhura
Janë pengu ose gjaku i gjyshërve
Që lulëzojnë në çdo stinë
Duke i stolisur dhembjet
E së kaluarës nëpër vazot e shekujve

Kjo fushë e bardhë me lule të kuqe
Ujitur me hingëllima kuajsh
Dhe lot nënash
Askund nuk shpërthejnë nga toka
Kaq të bukura
Se sa në shpirtin e plagosur
Të Fushës së Mëllenjave

KUR FUSHA E MËLLENJAVE I SHKUND SHPATULLAT

I shkyçëm të gjitha shpresat
Asnjë dritare nuk hapet në horizont
Fusha e trishtuar
Noton në vetminë e natës vrastare

Disa korba të verbër
I mbjellin krakëllimat e zeza
Në shpirtin e bardhë
Të Fushës së Mëllenjave dënes një nënë

Në çdo cep të rrugës
Mbin nga një përmendore e mesjetës
Sterra fut e zezë buron
Nga shpirti i degjeneruar i Ballkanit

Disa hije të ngrira depërtojnë
Nëpër ashtin e thyer të atdheut
Mëllenjave si para pesë
E më shumë shekujve
Një duhmë e rënd dheu ua prush gjumin

Nuk flenë as korbat
Nëpër netët e zeza si zvarranikët parahistorik
Ulërin bishat e egra
Fusha e Mëllenjave i shkund shpatullat

Një shi prej bryme
Cikli i dytë

NJË KRYQ SI LISAT ENDET NËPËR VARRE

Një dorë e madhe pa formë
Groteske si sekreti i natës
Afrohet pranë luleve të porsaçelura
Dhe me fashat e trishtimit
Ua mbyllë gojën zogjve të natës

Zëri i vrazhdë i erës
I thyen xhamat
E një kornize Bizantine
Nga lagështia e mureve të mykura
Çurgon eliksiri i trishtimit

Dritaret me shekuj të tëra
Nuk janë hapur këtu
Edhe dyert qëndrojnë të mbyllura
Asnjë gojë njeriu s'i lëviz buzët
Nuk bëzan
As era e plagosur në shpirt

Një kryq si lisat endet nëpër varre
Akaciet e bardha
I shkundin lulet e para të pranverës
Dimri ishte i vështirë sivjet
Për disa vite i ngriu ullukët e çative të djegur

I NGRIU TË GJITHA SHPRESAT

I hapi dritaret e mjegullave
Nga lagja e verdhë qielli i ngrysur
Hynë në dhomën time
Në një vazo të vetmuar
I fishku lulet e një stine

Rruga tërmal kujtesës
I ka me qindra kthesa
Nëse i humbi duart në kthesën e parë
Kurrë më nuk mund të mbërri
Ta shoh kthesën e fundit

Dudat e kuqe sivjet
Nuk kanë çelur asnjë lule
Nga gjethet e zbehta
Pikon një lloj eliksiri për shërimin
E kujtesës së humbur

As akaciet nuk luluan në pranverë
Dimri ishte i acartë
I ngriu të gjitha shpresat
Që i ushqente
Bari i kositur në vjeshtë

ASNJË PORTË NUK HAPET

Kah të shkoj sonte
Në cilat porta të trokas
Ti nuk je askund në këtë hapësirë
Të ngarkuar me qeska najloni
U largove me lejlekët e parë të vjeshtës

Sonte vetëm një zog i vetmuar
Troket në dritaren time
Kujt t'i hapi dyert e mbyllura
Këtë dry të ndryshkur në tru
Asnjë çelës nuk e hap

Era sërish frynë dhe troket
Çmendurisht troket në dyert e mbyllura
Asnjë njeri i gjallë nuk dëgjohet përbrenda
Vetëm dryni i vjetër
Cijat si trishtili i sëmurë në degë

Ku të trokas në këto çaste dhembjeje
Ky qytet i imi
I paska mbyllur kujtimet
Asnjë portë nuk hapet
Kurse era po i gozhdon të gjitha dritaret

BISEDOJNË KUR I ZË ETJA

Ishte koha kur nuk flisnin njerëzit
Një heshtje e pllakosur
Kalonte rrugicave që s'bëzanin
Fëmijët i kishin fshehur lodrat
Vetëm era lozte
Me degët e thyera të një përralle

Thonë se në luftë nuk flasin njerëzit
Vetëm armët kanë
Një gjuhë të çmendur
Bisedojnë kur i zë etja
Dhe heshtin kur ngopen me gjak njeriu

Ditët janë ters nuk i përngjajnë asgjëje
As jetës e as vdekjes
Gota e mbushur me dhembje
Derdhet ngadalë
Derdhet deri në pikën e ngrirjes

Në oborr bie një shi shrapnelash
Nga të katër anët e qiellit
Granatat pështyjnë
Zogjtë e hekurt ngarkuar me shpresë
Fluturojnë nëpër qiellin e vrarë të Kosovës

NUK BËZANIN AS KLERIKËT

Një duhmë e rëndë
Ia kishte zënë frymën ditës
Në duart e thyera
Të degës së gështenjës
Nuk merrte frymë as ajri i tendosur

Edhe lisat e gjatë
Përngjanin me vdekjet
Nuk bëzajnë as klerikët
Nëpër faltoret e heshtura lozin bubuzhelet

Kambana dhe minarja
Kishin rënë në dy gjunjë
Dhe mbanin nëpër duar
Si librin e shenjtë
Mendjen e trazuar të luftës

Nuk dëgjohen sonte
As hingëllimat e kuajve
Bari i kositur
Fishket nga plagët e ndryshkura

Një tren në stacionin e qytetit
Ngjante me njerëzit
Që udhëtonin dhunshëm
Në një vend që nuk i ngjante asgjëje

PLEPI I VJETËR I SHKUND GJETHET

Tashmë janë mbyllur
Të gjitha dyert e fjalëve
Nëpër lagje kalonin njerëz
Me disa lloje drynash në fulqi
Një urë e gjatë tmerrohet
Kur kapërcejnë mbi të kafkat e një kohe

Me shpirtin e drurëve uji i frikësuar
I lanë duart
Nga sklepat e syve të sëmurë
Pikojnë shikimet e boshatisura
Koralet fshihen pas gurëve të murrmë
E shiu i shurdhët nuk pranë

Disa njerëz me kukëza
Kalojnë tërmal kalldrëmit
Kalojnë deri te plepi i vjetër
Dhembja i shkund gjethet
I shkund trishtimet e një tragjedie

Njerëzit nuk patën më mundësi
Të ecin nëpër golgotën e frikës
Mbrëmja i kishte lëshuar krahët
Mbi thinjat e flokëve të çative të rrënuara
Binte nga pak një shtrezë e tejdukshme

DUKE ECUR UDHËVE ASNJANËSE

Duke ecur udhëve
Duke gjurmuar nëpër shpirtin e erës
Njeriu padashur
Takohet me vetveten
Nxjerr krehrin nga xhepi i vogël
I setrës së grisur
Dhe i kreh kujtimet

Duke mos u ndalur në asnjë lima
Udhëtimi nuk përfundon
Valixhja e vjetër
Kollitet si një njeri i moshuar
Peshqit e ngordhur protestojnë
Nëpër tasat e palara të konservave

Duke ecur nëpër binarët paralel
Të trenave mbërrin diku
Në fund të kotësisë
Ku gjelat e mëngjeseve të dyshimtë
Ta prishin gjumin në fillim të ditës

Duke ecur udhëve asnjanëse
Takon njerëz
Me dhe pa mendime
Erërat gjigande
Që i shkulin shtëpitë me rrënjë

Takon vetveten
Të strukur diku në ndonjë
Tregim të harruar nga njerëzit
Dhe në mes të ndonjë rruge të dehur
Ulesh buzë bregut të ngrirë
Ku qeshin dhe qajnë pemët esëll

NUK MBYLLEN AS DRITARET

Nëse udhëton shpesh
Nëpër rrugë sheh autobus të përgjumur
Mauna të ngarkuar me mallra kaçak
Stacione që s'dinë se si duket mikpritja

Nëpër trotuare sheh bajga qensh
Dhe zonja të dehura
Që çojnë dashuri me polic të shthurur
Shtëpitë që s'kanë dritare

Në dyert e dhomave asnjë çelës
Nuk mbyllen as dritaret
Qyteti fantazmë kollitet vetëm atëherë
Kur pushojnë të reshurat

Macet e lazdruara flenë mbi çatitë
Ku asnjëherë nuk kalon dielli
Nëse udhëton nëpër qytete të tilla
Të duhet një maskë e re për fytyrën tënde

FLENË ME KOKË TË NGRITUR LARTË

Disa lloje të statujave
Kanë filluar të ecin nëpër zbrazëtirat
E trotuareve të qytetit
Prej atyre të hershme
Deri të ato të vonshme buzëqeshin
Kalimtarëve të rastit

Me mauna të vjetra
Transportohen pula të ngrira
Udhëtojnë edhe njerëzit
Në qytetin tim barten rrugëve duaj
Dhe kallinj të kalbur prej shirave

Autobusët vijnë kohë pas kohe
Nuk ka kush t'i evitojë këto vonesa
Nëpër stacione trenash dhe të autobusëve
Njerëzit ngjajnë me rosakët e egër
Flenë me kokë të ngritur lartë

Kur afrohen ditët e vikendeve
Qyteti zbrazet
Asnjë njeri nuk afrohet sporteleve
Gazetat shumë pak shiten
Dhe të dielave njerëzit nuk shkojnë në kishë

NATA PASKA IKUR SHUMË LARG

Nëpër rrugët e pluhurosura të qytetit
Kalojnë njerëz
Me fytyra të rrudhosura
Dhe vasha të bukura
Nga lëvizjet e të cilave
Ekzaltohet secili kalimtarë

Kur kalon njeriu
Pranë tavernave të errëta
Sheh të dehurit se si luajnë në violinë
Kënga zbret nga degët
Dhe shoqërohet me zogjtë endacak
I tërë qyteti vallëzon një vals prej shiu

Nën Urën e Gurit
Një çun shkruante një letër dashurie
Algat veç i kanë përfunduar serenatat
Nata paska ikur shumë larg
Sa që mëngjesi
Duket nga çatitë më të ulëta të qytetit

Kalaja akoma qëndron në majë mali
Dhe me sy të gjelbër të mbrëmjes
I përcjellë të reshurat deri te Drini i Bardhë
Faltoret e lodhura dhe të përgjumura
Akoma s’janë këndellur nga nata e kaluar

I NGJAJNË PATAVE TË EGRA

Kalojnë rrugëve të qytetit
Njerëz me mendime të zbrazëta
Nëpër fytyrat e tyre të lodhura
Shkunden vitet
Shkunden si mollët e papjekura
Edhe stinët e lodhura

Njëri kalon tërmal rrugës
Kurse tjetri
Tatëpjetë turbullirës së ujit
Fytyrat e zbehta si të këputura
Nga degët e thara të limonit
Duken edhe më të verdha në shi

Në ajrin e ndotur të qytetit
Rri varur si në ndonjë çengel kasapi
Portreti i shthurur i erës
Një vazo me lule të fishkura
Pretë çastin e të reshurave

Por shirat sivjet nuk erdhën
As në pranverë
E as në vjeshtën e vonë
Ndoshta do të na vijnë dimrit
Sepse shirat e qytetit tim
I ngjajnë patave të egra

SHKOJNË PAS ËNDRRAVE TË KALTRA

Tani më fëmijët tanë
Ngjajnë me zogjtë shtegtarë
Posa çelë pranvera
Në shpirtin e tyre të brishtë
Fluturojnë zogjtë e bardhë
Hapësirave të paanë

Si kuajt e egër trokojnë
Pas ëndrrave të kaltra
Nuk ndalen në asnjë liman
Ose stacion trenash
As nëpër pistat e mendjeve

Ëndrra e tyre e bardhë
Është i vetmi stacion
Ku ndalen njerëzit e dashuruar
Kur mbërrin në vendin
Dhe cakun e duhur

E lëshojnë spirancën e zhgjëndrrës
Dhe aq bukur ëndërrojnë
Për jetën e bletës
Sa që nga gishtat e tyre pikojnë yjet

KUR SËRISH I HAPËM SYTË

I hapi sytë
Asgjë nuk shoh përtej kujtesës
Një njeri i moshuar
Del nga lëkura e tokës
Dhe pranë rrapit të vjetër
I mbështetet supeve të ajrit

Në brendinë e gjetheve të njoma
Rritet një fjalë e urtë
Zemra rreh për zemër
Kur era belbëzon ninullat e fëmijërisë
E guri i atdheut ndjen etjen e tokës

Në këto çaste vendimtare
Fëmijët na braktisin
Ngjajnë më zogjtë e stinëve
Ikin diku larg
Ikin të dimërojnë në brigjet e fjalëve

Kur sërish i hapim sytë
Pas shpine roli i jetës
I lëshon dhe i mbyllë perdet
Teatri antik me mija vjet më herët
Nuk mungoi në arsyen e njeriut

PROTEZAT E DUARVE TË MIKUT TIM

Ishte koha e gjumit
Ai njeri gjeti një gotë prej plastike
Dhe i vuri në të
Protezat e dhëmbëve artificial

Nata pa asnjë asht në gojë
Kafshoi sterrën
Nga trupi i dërmuar i një meteori
Filloi të pikonte trishtimi i ditës

Ende më kujtohet ajo kohë e hidhur
Më kujtohen
Protezat e duarve të mikut tim
Kur fqinji i tij ardhacak
I dogji në furrën e gëlqeres

A MUND TË MBËRRI SONTE

Çfarë të bëj me ty
Ose me vetveten në këto çaste
Kur jemi kaq larg njëri - tjetrit
Një yll i vetmuar
Po mbytet në pellgun e trishtë të qiellit

Si të kaloj në anën tjetër të lumit
Kur është kaq e gjatë kjo urë
Këndej s'mund të rri
Kurse as andej s'kam se si të shkoj
Më ka sfilitur kjo moshë

Si të kaloj andej fjalës
Kur më mbytet gjuha e mishtë
Në detin memec të mendimeve
Kjo urë e gjatë
A mund të mbërri sonte
Të dal përtej turbullirës së ujit

SI NGA FERRI VIJNË DISA ZËRA

Nata rrinte mbuluar
Me një çarçaf të bardhë prej bore
Ethet e zeza nuk ndaleshin
Djersitja e mureve gërryente kujtesën
Shiu i shpeshtë dhe i turbullt
Përtypej mbi çati

Nëpër zgërbonja rrapesh dëgjohen
Uturimat e cirqeve
Si nga ferri vijnë disa zëra
Dhe përplasen
Mbi rrasat e kuqe të Kabashit

Mes përrallave të lashta oshtin
Zëri i Ashtës së Keqe
Një thikë e topitur
Fundoset në gjakun e njerëzve
Nga sytë e hënës çurgon sterra e ligështuar

Prishtinë, 6 korrik 2014

TË THASH SE SONTE NUK KA VDEKJE

Sërish po të them
Se sonte nuk ka vdekje
Mes këtyre pemëve të njoma
Ne do të ecim deri në fund
Do t'i ndjekim itineraret e yjeve

Të thash se sonte nuk ka vdekje
S'kemi kurrfarë nevoje
Të blejmë ndonjë arkivol të përdorur
Në tregun e gjësendeve
Era ishte aq e fortë mbrëmë
Sa që i shkundi pemët në kopsht

Ti nuk më besove asnjëherë
Edhe sot s'po më beson
Kur them se nuk ka vdekje
Mani i kuq u zgjua herët në mëngjes
Dhe hyri në grevë urie
Tok me manin e bardhë

Ti edhe sot më dukesh më e ngarkuar
Me inatet e tua të vogla
Dhe nuk më beson kur them se
Se sonte nuk ka vdekje
Pemët marrin frymë normalisht si njerëzit

MBI GËRSHETAT E TUA TË THINJURA

Sonte asgjë nuk më mungon
Në këtë dhomë të madhe
Të gjitha zbrazëtit e jetës sime
I plotësoi prania e jote

Me askënd nuk dua ta ndaj këtë natë
Le të jetë vetëm e jona
Si ajo natë e një shtatori të largët
Kur buzëqeshte dashuria
Mbi një çati të mbuluar me kashtë thekre

Aspak s'ke ndryshuar
Po ai ballë shndrin
Si ai i hënës pa asnjë vragë
Shtrihet nën qerpikët e zinj
Ku mrizojnë
Dy kroje të ngrohta dhe të pashtershme

Sonte asgjë nuk më mungon
Ah të isha i ri
Si atë natë shtatori
Do i zbrisja të gjitha yjet e qiellit
Mbi gërshetat e tua të thinjura

I SHIKON MAJAT E MALEVE

Me dryna të ndryshkura
Rrinë të mbyllura dyert e haneve
S'ka njeri që mund t'i hap
Ato porta të drunjta
Koha i ka ngrënë trarët e tymosur
Çatitë janë lëshuar në gjysmë shtize
Dhe heshtin si gurtë

Oxhaqet ka kohë që nuk pleqërojnë
Një tym i bardhë
Me ca vija dredharake
I shikon majat e maleve
As vorba me pastërma dhe fasule
Nuk zihet pasditeve të vona
Një tjetër kohë
Ka marr udhë këtyre maleve

Asnjë udhëtarë i vonuar
Më nuk kalon këndej pari
Ose ata që bredhin maleve
Pa miq dhe dorëzanë
Vetëm ndonjë lahutarë i vetmuar
Kur e zë nata
Po s'patë se ku të strehohet
Nën çatinë e rrënuar të ndonjë hani
E pret mëngjesin të zgjohet me këndesat

ASGJË NUK MË DUHET SONTE

Nuk jam i uritur
Asgjë nuk dua në këto çaste
Kaluan kohërat
Kur i kafshoja mollët nëpër degë
Mund të ma jepni vetëm një gotë ujë
Nga burimi i pikës së vesës
Ta shuaj etjen e rinisë

Ju thash edhe më parë
Asgjë nuk dua
Mos ju kanë lënë veshët si mua
Unë nuk kam uri
Me të gjitha të ligat e ditëve të sotme
Më ngopi jeta
Çfarë mund të pres sot në këtë moshë

Shikoni këtë pemë të verdhë
Asnjë flutur e kaltër
Nuk paska mbetur këtu
Kanë ikur edhe merimangat e vjeshtës
Edhe këto fryte të papjekura
Mund të m'i thyejnë protezat
S'jam i uritur
Asgjë nuk më duhet sonte

NJË SHI PREJ BRYME

Pemët e zhveshura
Kanë rënë në dy gjunjë dhe i luten erës
Kopshti i ngufatur
Nga mjegullat e mëngjesit
I shëron plagët e bardhe të shirave
Vjeshta po i fsheh duart e ngrira të stinës
Rrapet më nuk këndojnë serenata

Plakat i kanë mbuluar kokat
Me shamia të zeza
Dhe si të turpëruara kashaisin
Trungjet e djegura të pemëve
Shirat nuk duken askund
Edhe sivjet bari i fishkur
Po vuan nga zjarrmia

Gështenjën e vjetër
Po e ngacmon kolla e keqe
Edhe pemët e tjera
Nuk janë në gjendje më të mirë
Një shi prej bryme e kalli gjelbërimin
Sa që sot gjethet e zverdhura
Po vuajnë nga lemza

FANARI I VJETËR

Velat e grisura shikojnë
Se si përmbyten anijet e braktisura
Një flamur i vetmuar
Në shpirtin e detit të trazuar
E lëshoi spirancën

Dallgët më nuk kishin kohë
Një kep i çmendur midis detit
Dashuronte sirenën e një përralle të vjetër
Anijet fundoseshin
Në shpirtin e dehur të zhurit

Dielli kishte ikur larg tokës
Ishte pika më e lartë e zenitit
Megjithatë
Nga uria vuante peshku i artë

Sërish një dallgë e fortë
Përplasej shkëmbinjve të egër
Ishte si jehona e thellësisë së detit
Moli i përgjumur akoma po kotet
Fanari i vjetër
Herë i kyçte e herë shkyçte dritat

NGJAJNË PËRMBYTJET E MËDHA

Sandalet e mia të vjetra
Si varka të harruara
Përkunden në gjumin e dallgëve
Një natë e mbushur me poezi
I këndon serenatat e saja brigjeve
Këndojnë edhe karkalecat

Zëri i shurdhët i ujit
Heshtas depërton
Në ëndrrën e guacës së verbër
Peshqit fluturues kalojnë matanë brigjeve
Shkuma e dendur e kripës
Bisedon me ninullat e fjetura të një varke

Një njeri i vetmuar i përqafon brigjet
Detet fshihen në guallin e guacës
Deniku veç i ka shtrirë krahët
Në drejtim të maleve të mira
Dhe i përqafon zanat e malit

Në stërkala valësh
Ngjajnë përmbytjet e mëdha
Deti del nga ëndrra e furtunës
Dhe me një njeri sykaltër
U ndihmon anijeve të fundosura

NË AROMËN E LULEVE

Sa e sa herë shkelëm
Mbi gjymtyrët e lodhura të tokës
U lodhëm edhe ne
Nga lodhjet e pandërprera
Gjymtyrët na shikojnë me njëfarë ironie
Jashtë në rrugë kollitej druri i sëmurë

Dyqanet nuk hapeshin të dielave
Vetëm dyert e kishës rrapëllonin
Prej psalmeve të vjetra
Nuk kishte mbetur asnjë kujtim
Për të cilin mund të diskutonim

Dikur vonë kur afrohej muzgu
I mbrëmjes së dërmuar
Dielli fshihej pas maleve të larta
Të Hasit të Gurit
Kurse Drini i Bardhë gjarpëronte i përgjumur

Qyteti buzë Lumëbardhit ulej këmbëkryq
Nëpër kopshtet e zambakëve
Dhe shijonte me delikates
Ngjarjet e ditës
Në aromën e luleve
Që nuk fishkeshin asnjëherë

DOMOSDO DUHET TË DËGJOSH

Po s’pate arsye shkyçi mendimet
Dhe mbuloje kokën tënde tullace
Me jorganin e trishtimit
Prej njeriut që i mungon arsyeja
Asgjë nuk presin
As mizat e mërzitshme

Futi duart e tua të mëdha
Në xhepat e erës
Ose gishtat e gjatë mes buzëve
Dhe fërshëlle si i çmendur
Melodinë e harruar të gjelbërimit

Poqë se nuk të kujtohet se si fërshëllehet
Merre një gjethe të akacies
Fryj në të
Derisa të trashen buzët
Domosdo do dëgjosh
Një melodi të lashtë prej gjetheve

SONTE PËR HERË TË PARË KUPTOVA

Syri im i dehur
Po deshe
Preke me gishtat e tua skelet
Fundin e gotës ose të një tregimi
I cili do gjej vend në ditarin e erës

Mos më prek sonte qe dymijë vjet
Po i shikoj yjet se si ngarendin
Prej një ane
Në anën tjetër të hapësirës
Vetëm meteorët me bisht
I përcjellin lëvizjet e mia me xhelozi

Sonte për herë të parë kuptova
Se si fundosen yjet
Në shpirtin e zbrazët të detit
Mbase fundosen
Për t'i gjetur anijet e humbura
Sepse në një kep të Oqeanit Atlantik
Për çdo ditë këndon një sirenë e virgjër

Syri im i dehur
Po deshe
Preke me gishtat e tua të brishta
Ëndrrën time prej uji

PAS SHPINE PAMJA IME E KËRRUSUR

Asgjë nuk është e imja
As këto duar
Që u përngjajnë degëve të thata
Kjo natë e gjatë lëkurë regjur
E paska mbështetur shpinën
Për trupin e një lisi të lënduar

Nga majat e pemëve
Një nga një po shkunden stinët
Një vjeshtë bie egërsisht
Kurse stina tjetër
I përngjan perëndive pa fron
Përherë rri ulur
Në plagën e një tjetër stine

Siç duket për çdo ditë
Para këmbëve të mia po shket koha
Po shkasin si nëpër akull
Hukamat e damarëve
Një zog i trishtuar
Me qindra vjet nuk zbret nga pema e egër

Pas shpine pamja ime e kërrusur
I dëgjon rrapëllimat e dyerve
Trokëllin edhe drynat e ndryshkur
Mbi barin e fishkur të kujtesës
Deri në pafundësi
Notojnë duart e mia prej degëve

NË KËTO ÇASTE NUK KA VEND ASKUSH KËTU

Sonte do t'i mbyllim të gjitha dritaret
Nuk ka vend as nata këtu
Vetëm duart e tua të brishta
Mund të qëndrojnë
Mbi degët e mendimeve të mia

Po ju them për askënd
Nuk do të kemi mirëkuptim
E kush na duhet në këto çaste
Kur duart e tua
Si shelgjet e pikëlluara
Dënesin mbi plagët e një poeme

Sonte nuk ka vend
Për asnjë poezi këtu
Do i lëmë rehat edhe lirikat e idileve
Vetëm frymëmarrja e erës
Mund të hyj
Nëpër të çarat e mureve të vjetra

Sonte nuk ka vend askush këtu
As vetmia ime
Që më rri si oreol mbi kokë
Vetëm flokët e tua të sermta
Mund të m'i mbështjellin plagët
Që me vitet të tëra kullojnë dhembje

KY SHI I VONSHËM I VJESHTËS

Po deshe këputi këto yje
Që vezullojnë si xhevahire
Nëpër sytë e kaltër të mjegullave
Vezullojnë
Si kokrrat e pjergullës së kuqe

Nata është e gjatë
Nëpër rrugët e saja të vetmuara
Sonte mund të shëtisin
Vetëm të dashuruarit

Të lutem
Më prit në kujtesën tënde
Më prit nëse nuk vij unë
Do më sjellin miqtë e mi
Me një arkivol të gjelbër

Sa qenkan të etura
Duart e brishta të hënës
Ky shi i vonshëm i vjeshtës
Do i ngopi
Të gjitha pemët e kopshteve të thara

Po deshe futu sonte
Me këmishën tënde të fjetjes
Në ëndrrën time të virgjër
Depërto nëpër kujtesën e kohës
Dhe ujiti pemët e thara të stinëve

I pjek pëllumbat prej argjile
Cikli i tretë

TRINGA E GRUDËS

Punë e madhe
Që sonte askush nuk këndon
Vetëm një akrobat lidhur për telin e fatit
Vrapon nëpër shpirtin e errësirë

Ju keni mbetur shumë larg nga zëri i juaj
Shurdhmemecët konvertohen
Në këngëtarë operash
Dhe si çamçakëzin i përtypin ariet

Mbase jemi diku në mjedis të udhës
Dikush me një të rrahur
Të sëpatës
E preu rrugën në dysh
I ngjante shenjtorit që e ndau detin
Në dy pjesë të pabarabarta

Një pëllumb i bardhë
Fluturoi mbi fronin e mjegullave
Dhe filloi me deklamimin
E vargjeve të Fishtës
Tringa e Grudës rrëqethej
Kah i dëgjonte
Ulërimat e kullës së barotit

Prishtinë, 7 korrik 2014

GJUMIN E BËJNË ME NJËRIN SY

Po të kisha kohë dhe mundësi
Do bëja sonte
Një gjysmë sy gjumi
Atje lartë te majat e maleve
Nuk flenë as shokët e mi

Pas çdo lisi e rrapi të moçëm
Mbin një lloj druri i tradhtisë
Duhet bërë gjumë me sy të hapur
Se në të kundërtën
Posa i mbyllë sytë të kafshojnë drurët

Hijet e lashta këtu
Kanë disa hije të tjera të rënda
Sa herë zgjohen ata që kanë fjetur
Kanë një kokë dhembje të fortë
Që nuk krahasohet me asnjë sëmundje tjetër

Edhe gjethet e zverdhura
Ngjajnë me njerëzit
Shumë pak flenë
Edhe kur i mashtron nata
Po që se mashtrohen
Gjumin e bëjnë me njërin sy

TËRË JETA IME

Më ka mbetur shumë pak kohë
Për numërimin e ditëve
Ose të trishtimeve
Tërë jeta ime
Kaloi nëpër një urë të ngushtë

Vera më dukej si dimër
Kurse dimrat kurrë nuk kam ditur
Se me të cilat stinë t'i krahasoj
Aq shumë kisha dhembje në shpirt
Sa që i harroja ditët në vijimësi

Më besoni qeshja për mua
Ka qenë një nocion i huaj
Sa herë që i lëvizja buzët e mavijosura
Pikonte një lloj trishtimi
I ngjizur me dhembjen e kohës

Kështu u rrita
Dhe u rritën miqtë e mi
Përherë në jetë na përcillte një hije
E murrme që na e zinte frymën
Në ato çaste
Kur mund të merrnim frymë

PËR ÇUDI HESHT EDHE QIRIU

Ti nuk bisedon
S'dëgjohet më ai zë baritoni
Çdo lis pranë varrit tënd
Është fundosur thellë
Në shpirtin e heshtjes së përditshmërisë

Për çudi hesht edhe qiriu
Mbase po digjet me një flakë të heshtur
Imiton jetën tënde prej një babe
Përherë ke qenë i vranët
Ngjaje me mjegullat e atdheut të vjedhur

Vetëm qeshja e jote
Prej një burri të vendosur
Tregonte fuqinë tënde të brendshme
Gurgullonte si Drini i Bardhë
Nëpër brigjet e thepisura të jetës

Ti edhe sot nuk bisedon me askënd
Vetëm heshtja e qiriut tregon maturinë
E fjalëve të një njeriu
I cili askurrë nuk foli asnjë fjalë
Kur s'kishte çfarë me thënë

NGA DRURËT VEÇ KANË ZBRITUR NJERËZIT

Ulesh mbi supin e një druri
Dhe përgjon heshtjen tënde
Matanë lumit
Një mëllenjë e kaltër i lëshoi vezët
Në shuplakat e zhurit të përflakur
Digjen gishtat e drurëve

Sheh se si dita udhëton me një varkë të vjetër
Mbase e pret një rrugë e gjatë
Ti sërish nuk zbret nga druri
Shikon me habi mëllenjën në miniaturë
Që po krijon një botë të madhe

As era s'përpëlitet s'lëvizin as degët
Një ngërç i paparë frymon në hapësirë
Nga drurët veç kanë zbritur njerëzit
Dhe nëpër rrasat bjeshkëve të egra
I shkruajnë epitafet e para

KUR JANË MES DY STINËVE

Njerëzit ngjajnë me portretin e dimrit
Ecin rrugëve me flokë prej dëbore
Kur i shtrin duart
Si djersët e ftohtë të vjeshtës
Nga gishtat skelet pikojnë kallkanët

Kur janë mes dy stinëve
Si gjarpinjtë i ndërrojnë këmishët
Një ditë ecin kryelartë si këndesat
Kurse ditën tjetër
Zvarriten nëpër mjerimin e tyre

Duken se ngjajnë edhe me perëndit
Por bien aq ultë
Sa që kur ngritën në këmbë
I zë marramendja
Dhe lëshohen pingul në tokë
Pranë rrënjës së kalbur të degës së sëmurë

VETËM KËPUCËT PREJ LLASTIKU

Secili prej nesh duhet të dalim
Nga lëkura e jonë
T'i arnojmë pantallonat e shqyera
Me plagët e viteve

Shikoni këpucët e mia
Shikoni se si e kanë hapur gojën
Don me gëlltit rrugën e shkelur me shekuj
Me i gëlltit tok me ëndrrat tona

Edhe këmisha ime me qindra arna
Varet mbi trapazan
Nuk ka njeri që mund të ja shëroj plagët
Ajo dergjet si një nuse lehonë

Po na ikën edhe kjo kohë e grisur
Asgjë nuk më ka mbetur nga e kaluara
Vetëm këpucët prej llastiku
Më presin të fshehura në një trastë të dhirtë

MIQTË E MI TË KËRRUSUR

I paskam harruar emrat e lagjeve
Ose këto ngjyra të luleve
Po ngjajnë
Me ngjyrën e kuq të dheut
Diçka nuk është në rregull
Me sytë e mi të gështenjtë

Nuk po i shoh gjërat ashtu
Siç i pata lënë dikur
Kjo urë që e ndanë qytetin
Në dy pjesë po qan si era

Pamjen e saj arkaike
E nuk paska ndryshuar
Kurse në anën tjetër
Akoma mund kalohet
Duke shkelur mbi shpirtin e saj

As njerëzit më s'janë ata
Që i njihja dikur
Qenkan plakur si bastunët e tyre
Ecin rrugëve të kalldrëmta
Dhe trokëllinë nëpër gurë
Si galopet e kuajve të dikurshëm

Miqtë e mi të kërrusur
Ecin me nga një shami në dorë
Duke i fshirë sklepat
Dhe kohë pas kohe
Dorën e djathtë e çojnë deri te hundët

Nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore
Kolliten si kuajt e sëmurë
Dikur që i kapnin yjet me dorë
Sot nuk janë në gjendje
Me i ndalë as gogësimat

KUR NA VININ FESTAT

Ende nuk i kam humbur rrugët
Do të kaloj këndej
Kah kemi kaluar të mbledhim dredhëza
Dhe t'i ndjekim pulat e egra

Ishin kohërat kur na mungonte ushqimi
Një kaçik pule vlente sa një deve
Në sofrën e uritur
Rrapëllonin lugët
Pas supës së ftohtë me hithra

Më kujtohet kur nëna na mashtronte
Duke i zier lëvoret e ahut
Buka ishte një ëndërr
E parealizueshme për ne
E shihnim vetëm nëpër dyqanet e pasanikëve

Këpucët tona ngjanin me lëkurën
E këmbëve të breshkës
Kur na vinin festat fetare i arnonim
Dhe i lustronim me dhjamë buallice

NJË TELEPATI E METALTË

Mbase celularit ja paske zënë frymën
Sa herë që cingëroj
Asnjë njeri nuk lajmërohet
Andej atij muri të shurdhtë

Mua më befason shumë kjo heshtje
Edhe celulari ngjan me ty
Jeni të njëjtë ti njeriu prej mishi
Kurse ai një copë plastike pa vesh

Nuk di më se kujt t'i drejtohem
Andej mendjes muri i akullt
Brenda në shpirtin e celularit
Një sustë e zezë nuk bëzan

Një telepati e metaltë lëshon rrënjë
Në shpirtin njerëzor
Hesht kur ka e s'ka nevojë
Dhe nganjëherë cingëron si ndërgjegjja

TË LUTEM DORA IME

Natën e mirë dora ime
Mos ma kruaj sonte shpinën
Druaj se do e lëndosh mendjen e lëkurës

Po bie nga pakë një shi i verdhë
Po bie mbi syprinën e kalldrëmeve
Nuset kanë dalë te kroi dhe po i krehin flokët

Janë sëmurë shtambat prej argjile
Nuk marrin frymë
Ngjajnë me njeriun që vuan nga etja

Syri im i djathtë nuk e sheh syrin e majtë
Të lutem dora ime
Mos m'i kruaj sonte kujtimet

DUKE U NGJITUR MAJAVE

Duart e tua arabeska fjalësh
Të zbrazëta
Si tingujt e një muzike të shthurur
Mëngjeseve herët zgjohen
Dhe nëpër muranat e faltoreve pagane
I lexojnë epitafet e së kaluarës

Nëpër rrëfyestore bie shi lotësh
Pendohen drurët
Me një fjalë goje lahen mëkatet e kaluara
Dhe ato që do pasojnë më vonë
Nga biri i birit të njeriut

Nëpër kishat e qytetit të vjetër
Kanë heshtur kambanat
Asnjë zë njeriu nuk dëgjohet
Rrugicave qorre

Vetëm një zog i vetmuar
Fluturon vërdallë
Fluturon deri në theqafje
Duke u ngjitur majave
Nëpër mëkatin
E papërmirësueshëm të njeriut

Prishtinë, 8 korrik 2014

TË CILAT HUMBJE
NA GËZONOIN PAMASË

Në këtë lagje të vogël
Ishte dikur shtëpia e jonë e madhe
Jetonim të lumtur
Pa brenga si zogjtë nëpër degë
Jetonim po ashtu me dëshira të vogla

Çatia e ultë ishte e mbuluar
Me kashtë thekre që s'pikonte askurrë
Për çudi
Asnjëherë nuk i njohëm vdekjet
Nën hijen e saj nuk vdisnin njerëzit

Kishim edhe çaste të hidhura
Më kujtohet kur qante nëna e madhe
Qanin edhe trarët e tymosura
Ajo me lot në sy
I përcillte nipat dhe djemtë e saj
Nëpër luftëra të huaja

Kishim edhe ditë të lumtura
Kur na ktheheshin shëndosh e mirë
Xhaxhallarët dhe baballarët tanë
E na rrëfenin me mburrje
Për humbjet e mëdha
Të cilat na gëzoni pa masë

SI NGA NJË VAZO PARAJSE

Mos trokitni sonte në derën time
Nuk jam vetëm
Me mua rri këmbëkryq
Përballë ikonës familjare
Vetmia ime e kahershme

Edhe nata është ulur mbi supin tim
Dhe i ujit vazot e pikëlluara
Në qoshe të dhomës së madhe
Dëgjoj një buzëqeshje
E cila është këputur nga lulet e kopshtit

Sonte jam fare mirë
Me një gotë të zbrazët prej kristali
I ujis kujtimet
Dhe bisedoj me lirikat e mbetura peng
Për një tjetër kohë
Ikonat pikturojnë këtë heshtje madhështore

Sonte nuk jam vetëm
E tërë bota qenka ulur përreth sofrës
Me pirunë dhe thikë të sermtë
Po ja shqyej rropullitë e një trishtimi
Sonte përballë ikonës familjare
Si nga një vazo parajse çelin lulet e vetmisë

KUR I ÇELË SYTË MËNGJESI

Nëpër një stacion të braktisur
Ecin valixhet
Vallëzon edhe nata një vals nëpër shi
Nën kapela të shqyera kalojnë njerëzit
Secili udhëton nëpër këtë natë
Duke e fshehur kokën prej vetvetes

Një shi idhnak troket me hidhërim
Nëpër xhamat e ajrit
Disa zogj shtegtarë pushojnë nën një pemë
Pushojnë si taksitë e lodhur
Nata ishte tepër e gjatë
Deri në ferr shkisnin rrotat e harxhuara

Kur i çelë sytë mëngjesi
Nëpër bankina
Buzë rrugëve të harruara
Zgjohen sytë mbushur me sklepa
Zgjohen lypësit e përgjumur
Kolonë duarsh të zgjatura shtrihen
Nëpër lagjet e qytetit me qepena të mbyllura

MBI BANKINAT E BRAKTISURA

Mes meje dhe kujtesës
Një rrugë e gjatë e kallkantë
Treni i mbrëmjes
Erdhi me shumë vonesë
Binarët i përtypte era

Mbi bankinat e braktisura
Fluturojnë zogjtë e nakatosur
Pranvera e humbi rrugën
Mes stinëve
Zgërdhihet një thikë e topitur

Ende kemi kohë për tu penduar
Ju lutem
Ndalni fluturimet e korbave
Nuk durohen sonte
Krakëllimat e kësaj nate

Ky shi i akullt i cili çmendurisht troket
Mbi xhamat e kujtesës
E paska futur kohën mes dy binarëve
Dhe po largohet diku
Si lypsarët me valixhe të arnuara

I PJEK PËLLUMBAT PREJ ARGJILE

Me një sqep gjigand
Dhe krah të padukshëm
Një zogj i vetmuar
Në pluhurin e yjeve po i lanë krahët

Hëna imiton fluturimin e mjegullave
Jashtë kohës dhe hapësirës
Sërish një zog
I shkund pendlat prej pluhuri

E tërë galaktika
Mbështjellë me hijet e brymta
Në një shkretëtirë të paanë
Shuan etjen e kaktusit

Një oazë ka rënë në dy gjunjë
Dhe i lutet devesë së verbët
Dielli i përskuqur
I pjek pëllumbat prej argjile

Prishtinë, 9 korrik 2014

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. **“Bajraktarët e vatanit”,** poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91**.”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

93. **“Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94**.”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”**Për që po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. **. “Si trenat e verbër ” ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. **“Zjarri i malli tim ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 **. “Kur teshtinë era** ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

108. "Mbi shpirtin e erës pagane " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
109. "Nëpër gjymtyrët e mjegullave " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
110"**Ajo nuk erdhi sonte"** Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
111."Një hënë e zhveshur",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
112. "**Nëpër plasaritjet e mureve",**Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
113."Mes telave gjembor ",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
114. "Të vizatosh një zog në mur",Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
115." Nuk flenë as kuajt e dehur" Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
116"Fluturojnë zogjtë e verbër " Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015
117. "Një shi prej bryme" , Poezi, Shtëpia Botuese "Trend" Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

Ulërinë gjethet e çmendura
Cikli i parë

Po ecin edhe rrugët 11
Në heshtje mortore 12
Ulërin gjethet e çmendura 13
Flenë mendjet e shthurura 14
Do kthehem te ti një ditë 15
Nuk pushojnë as ethet e verës 16
Me ujin e shenjtë të Dardanisë 17
Dënesin kuajt e plagosur 18
Sivjet po frynë një fllad i ri 19
Asnjë zë njeriu nuk dëgjohej 20
Dëgjoheshin edhe ulërimat 21
një re e zezë si nata 23
Këtu edhe netët dënesin 24
Derdhur nga sqepi i një mëllenje 25
Ky testament i gurtë 26
Erdhën edhe shirat e brymta 27
Kali im i bardhë 28
Nuk ngjajnë me asnjë stacion 29
Kështu përsëritet historia 31
Asnjëherë nuk ta pamë fytyrën 32
Fusha e mëllenjave 33
Kur fusha e mëllenjave i shkund shpatullat 34

Një shi prej bryme
Cikli i dytë

Një kryq si lisat endet nëpër varre 37
I ngriu të gjitha shpresat 38
Asnjë portë nuk hapet 39
Bisedojnë kur i zë etja 40
Nuk bëzanin as klerikët 41
Plepi i vjetër i shkund gjethet 42
Duke ecur udhëve asnjanëse 43
Nuk mbyllen as dritaret 45
Flenë me kokë të ngritur lartë 46
Nata paska ikur shumë larg 47
I ngjajnë patave të egra 48
Shkojnë pas ëndrrave të kaltra 49
Kur sërish i hapim sytë 50
Protezat e duarve të mikut tim 51
A mund të mbërri sonte 52
Si nga Ferri vijnë disa zëra 53
Të thash se sonte nuk ka vdekje 54
Mbi gërshetat e tua të thinjura 55
I shikon majat e maleve 56
Asgjë nuk më duhet sonte 57
Një shi prej bryme 58
Fanari i vjetër 59
Ngjajnë përmbytjet e mëdha 60
Në aromën e luleve 61
Domosdo duhet të dëgjosh 62
Sonte për herë të parë kuptova 63
Pas shpine pamja ime e kërrusur 64
Në këto çaste nuk ka askush vend këtu 66
Ky shi i vonshëm i vjeshtës 68

I pjekë pëllumbat prej argjile
Cikli i tretë

Tringa e Grudës 73
Gjumin e bëjnë me njërin sy 74
Tërë jeta ime 75
Për çudi hesht edhe qiriu 76
Nga drurët veç kanë zbritur njerëzit 77
Kur janë mes dy stinëve 78
Vetëm këpucët prej llastiku 79
Miqtë e mi të kërrusur 80
Kur na vinin festat 82
Një telepati e metaltë 83
Të lutem dora ime 84
Duke u ngjitur majave 85
Të cilat humbje na gëzojnë pamasë 86
Si nga një vazo parajse 87
Kur i çelë sytë mëngjesi 88
Mbi bankinat e braktisura 89
I pjek pëllumbat prej argjile 90

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Një shi prej bryme / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : Trend, 2015. – 104 f. ; 21 cm.

[Shënime për autorin] : f. 91-100

ISBN 978-9951-694-10-0